



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dërguar Prenjeno / Predato Received / Delivered	27.03.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organi / Jednica Org / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP/MSHCK	3029/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.362/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtare, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.362/2022 të datës 15.02.2023 të parashtruar nga ankuesja _____, nga Prishtina, kundër Vendimit me Nr. 01-116/02-2459 të datës 02.02.2023 të Komisionit Disiplinor në Komunën e Gjakovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 27.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.362/2023 e datës 15.02.2023 e parashtruar nga ankuesja _____

A r s y e t i m

Ankuesja _____, më datë 15.02.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit Nr. 01-116/02-2459 të datës 02.02.2023 të Komisionit Disiplinor në Komunën e Gjakovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.02.2023 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses në Komunën e Gjakovës. Këshilli më datë 15.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Gjakovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1796/2023 të datës 15.02.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër 01-116/02-2459; Emalin e datës 20.01.2023 të [redacted] drejtuar [redacted]; Emalin e datës 20.01.2023 të [redacted] drejtuar K.Alija; Emalin e datës 12.12.2022 të [redacted] drejtuar [redacted]; Emalin e datës 20.01.2023 të [redacted] drejtuar [redacted]; Emailin e datës 12.11.2022 të [redacted] drejtuar [redacted]; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i ulet dhe Profesional të datës 17.01.2023; Shpalljen e Martesës të datës 18.01.2023; Aktin e Martesës të datës 19.01.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 28.02.2023; Përgjigjeni në ankesë të datës 15.03.2023; Kërkesën e datës 20.01.2023 për Komisionin disiplinore; Emalin e datës 17.01.2023 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 17.01.2023 të F.Aliu drejtuar [redacted] Emalin e datës 17.01.2023 të [redacted] drejtuar [redacted]

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankueses, është e palejuar, *sepse*:

Ankuesja e punësuar ne komunën e Gjakovës ne pozitën e punës Udhëheqës e Sektorit për gjendje Civile me datën 20.01.2023 përmes Njesisë se Burimeve Njerëzore ne Komunën e Gjakovës ka parashtruar kërkesën me numër 01-116/01-1473 lidhur me iniciimin e procedurës disiplinore kundër nëpunësit M. Qupi me dyshim për shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor në Komunën e Gjakovës, pas mbajtës së seancës disiplinore më datë 24.01.2023, 27.01.2023, 30.01.2023, më datë 02.02.2023 ka nxjerr Vendim me Nr.01-116/02-2459 të me të cilin ka refuzuar kërkesën e znj. [redacted] " Udhëheqëse në Sektorin për Gjendje Civile" , pasi qe nuk ka gjetur dëshmi se z, [redacted] ka shkelje te përsëritur te rregullave te kodit te etikes ne Shërbimin Civil dhe se masa disiplinore e parashikuar ne paragrafin 1.1 te nenit 47 Ligjit Nr.06/L-114per Zyrtaret Publik, jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt, gjë e cila nuk është bërë nga Udhëheqësja e drejtpërdrejt, andaj duke u mbështetur ne atë qe u tha me larte Komisioni Disiplinore për nëpunësit e Shërbimit Civil ka refuzuar kërkesën me numër 01-116/01-1473 te datës 20.01.2023 te parashtruar nga znj [redacted] -Udhëheqëse e Sektorit për Gjendje Civile ne Komunën e Gjakovës.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 01-116/02-2459 të datës 02.02.023 të Komisionit Disiplinor të Komunës se Gjakovës, pretendon që Komisioni Disiplinor në këtë rast te vendosjes ka cenime te renda te procedurës, vërtetim te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike dhe aplikim te gabuar te se drejtës materiale.

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueses, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka analizuar dispozitat ligjore në fuqi, duke konstatuar se me nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcaktohet se: "Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimi në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative", ndërsa me nenin 124 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet legjitimimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative, ndërsa



paragrafi 1 i këtij neni përcakton që: "Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtarë i një organi kolegjal, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjal, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë", kështu që Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në këtë rast vlerëson se ankueses edhe si palë e tretë nuk i janë cenuar asnjë e drejtë nga marrëdhënia e saj e punës, rrjedhimisht nuk ka legjitimitet për parashtrim të ankesës kundër Vendimit me Nr. 01-116/02-2459 të datës 02.02.2023 të Komisionit Disiplinor në Komunën e Gjakovës.

Bazuar në këtë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mund të parashtrorjë vetëm nëpunësit civil të cilëve i'u janë shkelur të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, kështu që meqenëse ankesa e ankueses e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, të Kosovës nuk i plotëson kushtet për parashtrim të ankesës sipas nenit 124 paragrafi 1, nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, atëherë e njëjta konsiderohet se është pa pranueshme.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.362/2023

Ilire MEHMETI-SHAQIRI



Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës dhe;
- Arkivit të KPMShCK-së.